

Rev.nr.259/2017

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, mr.sc. Erdogan Haxhibeqiri dhe Isa Kelmendi, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit, S. Sh. nga fshati ..., K. Gjilan, të cilin sipas autorizimit i përfaqëson Sh. I., avokat nga Gj., kundër të paditurës KS "I.", me seli në Prishtinë, për anulimin e Aktmarrëveshjes për kompensimin e dëmit, duke vendosur lidhur me revizionin e të autorizuarit të paditësit, paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës së Apelit në Kosovë, Ac.nr.1366/2013 datë 19.09.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 09.1.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i paditësit, S. Sh., nga f..., ..., paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës së Apelit në Kosovë, Ac.nr.1366/2013 datë 19.09.2017 .

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Kosovë, Ac.nr.1366/2013 datë 19.09.2017, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.393/2009 datë 11.02.2013, me të cilën është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit , me të cilin ka kërkuar që të anulohet aktmarrëveshja për pranimin e vlerës së dëmit të nënshkruar më datë 20.9.2004, ashtu që vlera e kompensuar e dëmit në lartësi prej 11.898,00 €, caktohet në vlerë tjetër reale prej 48.000,00 € dhe kësaj vlere i zbritet vlera e inkasuar në shumë prej 11.898,00 €, ndërsa për vlerën e mbetur prej 36.102,00 €, obligohet e paditura që paditësit t'ia kompensoj në emër të dëmit material dhe jo material, për shpenzimet e shërimit, humbja e përgjithshme e aftësisë jetësore dhe për punë, frikë, dhimbje shpirtërore dhe shërim si dhe konform dispozitave të nenit 188 të LMD, paditësit i caktohet renta jetësore në shumë prej

250.00 €, si punëtor arsimit me kualifikim të lartë në Kosovë, si dhe shpenzimet e procedurës për shkak të parashtrimit të kërkesës.

Kundër aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi përmes të autorizuarit të tyre, me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të, shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të dy aktgjyqimet e gjykatave të instancës më të ulët të prishen dhe çështja t'i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjyqimit të goditur sipas nenit 215 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK) gjeti se:

Revizioni është i pabazuar.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij i është drejtuar të paditurës për kompensimin e dëmit nga aksidenti i komunikacionit që ka pësuar me datën 02.07.2003, nga mjeti motorik i siguruar TPL pranë I. sh.a. Palët ndërgjyqëse KS "I." sh.a. Dega në Kosovë-Prishtinë dhe në emër të dëmtuarit tani paditësit S. Sh. nga fshati ..., K..., avokati i tij Sh. I., nga ..., me datën 20.09.2004, kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore-aktmarrëveshje lidhur me kompensimin e dëmit të kërkuar. Me par.2 të kësaj aktmarrëveshje, palët nënshkruese bien dakord për shumën prej 11.898,00€, në emër të kompensimit të plotë të dëmit shëndetësor.

Në paragrafin 2 të aktmarrëveshjes i autorizuari i të paditurës dhe i autorizuari i paditësit janë pajtuar me pagesën e shumës së rënë dakord (të precizuar në par.2), që të gjitha kërkesat e tij për këtë dëm ndaj KS "I.." Dega në Kosovë, konsiderojnë plotësisht të përmbushura dhe nuk kanë asnjë pretendim të mëtejshëm financiar, ndaj kësaj kompanie. Kërkuesi i dëmshpërblimit obligohet që me këtë marrëveshje të tërheq padinë dhe kërkesëpadinë eventuale nëse ka paraqitur në gjykatë.

Paditësi nga e paditura kërkojnë revidimin e marrëveshjes për kompensimin e dëmit, të datës së datës 02.07.2003, komfor nenit 133 të LMD-së, për shkak të rrethanave të ndryshuara, sepse në

bazë të vlerësimit të komisionit mjekësor është vërë në lajthim, duke menduar se është përmirësuar gjendja shëndetësore dhe nuk do të ketë nevojë për shërim të mëtejshëm mirëpo më vonë gjendja e tij keqësohet dhe si pasojë e kësaj gjendje është dashur ti nënshtrohet 5 operacioneve.

Gjykata e shkallës së parë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit për anulimin e aktmarrëveshjes jashtëgjyqësore është e pa bazuar për arsye se nga koha e nënshkrimit të marrëveshjes jashtë gjyqësore në mesë të palëve ndërgjyqëse, e deri në paraqitjen e padisë kanë kaluar me tepër se tri vite , e duke u mbështetur në nenin 380 paragrafi 3 dhe 5 të LMD-së, ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën e ankimit ka pranuar si të drejtë dhe të ligjshëm konstatimin faktik dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, andaj ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Në arsyetimin e aktgjykimit ka dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike, për faktet relevante për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje juridike, që janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë. Faktet të cilat i ka vlerësuar gjykata e shkallës së dytë nuk vihen në pyetje thënie në revizion, provat tjera të analizuar më hollësisht nga gjykata e shkallës së dytë e materializojnë konstatimin e saj të fundit lidhur me zbatimin e së drejtës materiale me rastin e refuzimit të ankesës së paditësit.

Për më tepër kjo Gjykatë shton se, ujdia (aktmarrëveshja) në të vërtetë është kontratë me të cilën palët kontraktuese rregullojnë dhe përcaktojnë raportet e tyre reciproke në mënyrë të tillë që kjo marrëveshje përfaqëson pajtimin e tyre të ndërsjellë, në bazë të cilës kontesti përfundon në kuptim të dispozitës së nenit 411.1 të LPK. Si akt i tillë ka veprim juridik të përzier procedural dhe material, për këtë arsye përveç kushteve procedurale duhet të plotësojnë edhe ato materialo juridike.

Mbi këtë bazë tek ujdia-aktmarrëveshja, përveç dispozitave të LPK, rrjedhimisht aplikohen edhe dispozitat e LMD-së, në kuptim të kushteve të përgjithshme të lidhjes së ujdisë ashtu edhe kushteve të posaçme për lidhjen e ujdisë si punë juridike. Kusht kryesor për lidhjen e ujdisë, në bazë të nenit 1089 al.1 të LMD-së, është ekzistimi i lëshimeve të ndërsjella të dy palëve, ky kusht, në të vërtetë, paraqet thelbin e ujdisë si dhe kauzën e saj. Andaj , mund të thuhet se lëshimi reciprok i të dy palëve kontraktuese lidhur me ndonjë paqartësi në ndonjë marrëdhënie juridike krijon lehtësi reciproke, që përmban elementin thelbësorë të zgjidhjes së marrëveshjes në mes tyre. Sipas këtij kuptimi, nuk do të kishte pajtim dhe as zgjidhje nëse nuk ka lehtësime reciproke dhe pajtime të ndërsjella.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktmarrëveshja e lidhur në mesë palëve ndërgjyqjese prodhon efekte juridike pasi që nga vet përmbajtja e shkresave në lëndë rezulton se, në rastin konkret me aktmarrëveshjen e lidhur mes palëve ndërgjyqëse ka pas lëshime të dyanshme me rastin e lidhjes së kësaj pasi që i autorizuari i paditësit në kërkesën e parashtruar me dt. 02.07.2003, nga e paditura ka kërkuar kompensimin e dëmit për në aksidentin e komunikacionit të pësuar me datën 02.07.2003 dhe me paragrafin 2 të aktmarrëveshjes palët nënshkrues se bien dakord për shumën prej 11.898,00 Euro, në emër të kompensimit të plotë të dëmit të shkaktuar. Nga jo rezulton se, në rastin konkret në rastin e lidhjes së kësaj ujdie-aktmarrëveshje është respektuar dispozita e nenit 1089.1 të LMD-së.

Paragrafi 2 i nenit 1089,të LMD-së, përcakton se çka konsiderohet paqartësi në rast të kontestit eventual ndërmjet palëve. Në kuptim të kësaj dispozite , paqartësia ekziston në rastet kur palët kanë mosmarrëveshje lidhur me ndonjë marrëdhënie juridike. Në këtë vështrim kjo dispozitë zgjeron mundësinë e palëve kontraktuese që të përcaktojnë detyrimet e tyre reciproke përmes kontratës së ujdisë për rastet kur ushtrimi i një të drejte të tyre në një marrëdhënie të caktuar juridike është i pasigurt. Në rastin konkret mosmarrëveshjet lidhur me ujdinë nuk mund të gjejnë zbatim pasi që vet i kërkuesi i dëmshpërblimit është pajtuar me këtë aktmarrëveshje dhe është obliguar që të tërheq padinë dhe kërkesëpadinë eventuale nëse e ka paraqitur në Gjykatë. Andaj, me heqjen dorë nga çështja paraprake, paditësi e ka humbur edhe bazën ligjore për të kërkuar anulimin e aktmarrëveshjes, pasi që në këtë çështje palët janë dakorduar përmes aktmarrëveshjes

për pranimin e dëmit të kërkuar të datës 20.09.2004,dhe mbi këtë bazë paditësit nuk kanë drejt për të kërkuar anulimin e aktmarrëveshjes, pasi që në pikën 3 të aktmarrëveshjes përfshihet se i dëmtuari akordohet se me pagesën e shumës së rënë dakord, të gjitha kërkesat e t'ia për këtë dëm ndaj Kompanisë së sigurimeve I., dega në Kosovë, i konsideron plotësisht të përmbushura dhe nuk ka asnjë pretendim të mëtejshëm financiar ndaj kësaj kompanie. Nëse marrin parasysh se këtë aktmarrëveshje e ka nënshkruar, vetë paditësi S. Sh. dhe i autorizuari Sh. I.,i cili është njëherë edhe avokat me profesion, ka qenë dashtë që paraprakisht të ketë në konsideratë edhe pasojat e përfshirjes së një deklaratë të tillë në aktmarrëveshje.

Përndryshe, për arsyet e dhëna nga kjo gjykatë, nga aspekti i zbatimit i së drejtës materiale, aktgjykimet e të dy gjykatave të instancës më të ulët janë të ligjshme, dhe çdo pretendim në revizion lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale është i papranueshëm dhe si të tilla refuzohen.

Parashtrimet në revizion në revizion lidhur me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, kjo gjykatë i vlerësoi dhe gjeti si të papranueshme, për faktin se parashtrimet e tilla nuk kanë ndikim në marrjen e vendimit në favor të paditësit pasi që të dy gjykatat drejtë kanë vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit për anulimin e aktmarrëveshjes jashtëgjyqësorë është e pazbazuar edhe në kuptim të nenit 380 paragrafi 3 dhe 5 të LMD-së, për arsye se nga koha e nënshkrimit të marrëveshjes jashtë gjyqësore në mesë të palëve ndërgjyqëse, e deri në paraqitjen e padisë kanë kaluar me tepër se tri vite .

Nga sa u tha më sipër me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Rev.nr.259/2017 datë 09.01.2018

**Kryetarja e kolegjit,
Gyltene Sylejmani**